Kronikë

# Sulmi ndaj servisit të celularëve në Babrru, zbardhen detaje: 18-vjeçari qëlloi 2 herë me kallash! U konfliktua me pronarin për telefonin e lënë për rregullim (EMRI)

*Veprimi kriminal i 18-vjeçarit dyshohet të ketë ardhur pas një debati me pronarin e servisit të celularëve, ku kishte dërguar një telefon për ta rregulluar. I pakënaqur me rezultatin e shërbimit, i riu ka debatuar me pronarin e servisit, duke përshkallëzuar në sulmin me armë zjarri më vonë.*

Sulmohet me armë zjarri servisi i celularëve në Babrru, 18-vjeçari qëllo
Report TV

Watch on

Redaksia
27 Qershor, 10:27 | **Përditesimi: 27 Qershor, 12:53**

Share | Post

EASYPAY

KAMËZ - Detaje të reja janë zbuluar nga sulmi me armë zjarri që një 18-vjeçar kreu mbrëmjen e 26 qershorit drejt një servisi celularësh në Babrru.

Policia njofton se adoleshenti Rejsi Muça qëlloi 2 herë me kallash drejt servisit të celularëve, që në ato momente ishte i mbyllur.

Veprimi kriminal i 18-vjeçarit dyshohet të ketë ardhur pas një debati me pronarin e servisit të celularëve, ku kishte dërguar një telefon për ta rregulluar. I pakënaqur me rezultatin e shërbimit, i riu ka debatuar me pronarin e servisit, duke përshkallëzuar në sulmin me armë zjarri më vonë.



LEXO EDHE:
**Shpalosi planin për Kuvend Kombëtar me 150 anëtarë, Rama i publikon ‘CV’-në: Kulluri i proceduar për rrahje, kanosje e vjedhje**

Fatmirësisht nuk raportohet për njerëz të lënduar, por dëme materiale në fasadën e jashtme dhe në ambientet e brendshme të servisit.

Adoleshti u kap nga policia rreth 3 kilometra larg vendit të ngjarjes teksa tentonte të largohej. Gjithashtu, gjatë kontrollit të zonës u gjet dhe u sekuestrua arma e zjarrit automatike, e përdorur në ngjarje, si dhe municion luftarak.

**Njoftimi i plotë i policisë:**

*Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 5, pas marrjes së njoftimit se në Babrru një shtetas kishte qëlluar me armë zjarri në drejtim të një servisi celularësh, organizuan menjëherë një operacion policor për identifikimin, lokalizimin dhe kapjen e autorit.*

*Nga veprimet hetimore u dokumentua se autori i dyshuar, shtetasi R. M., 18 vjeç, pas një konflikti për motive të dobëta me pronarin e servisit, shtetasin Xh. I., ka qëlluar dy herë me armë zjarri automatike në drejtim të biznesit, duke shkaktuar vetëm dëme materiale në fasadën e jashtme dhe në ambientet e brendshme.*

*Në kuadër të operacionit policor “Zbulimi” të organizuar dhe të zhvilluar në një kohë shumë të shkurtër, shërbimet e Policisë lokalizuan, rreth 3 kilometra larg vendit të ngjarjes, kapën dhe vunë në pranga shtetasin R. M., 18 vjeç.*

*Gjatë kontrollit të zonës u gjet dhe u sekuestrua arma e zjarrit automatike, e përdorur në ngjarje, si dhe municion luftarak.*

*Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.*

-------------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.**

K.M/Shqiptarja.com

TAG: Rejsi Muça | kamez | babrru | Tirane

## Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 24 Qershor, 15:40

**Si ju duket plani i protestës për të shpërndarë qeverinë e Kuvendin dhe zgjedhja me short mes qytetarëve?**

Më pëlqen | Nuk më pëlqen | Nuk realizohet

## Lajme të tjera



Me flamingo varur në pemë dhe pankarta kundër Ramës e Berishës, disa protestues e gdhijnë te kryeministria
29 Qershor, 10:15



Protestat në Tiranë/ Një grup tubuesish mblidhen te Kryesia e Kuvendit
29 Qershor, 10:04



Protesta/ Ritheksohen kërkesat drejtuar Ramës, askush nuk foli për platformën tjetër politike! Kritika nga podiumi për mënyrën e organizimit
28 Qershor, 19:24



Ardi Stefa: Po kontrolloj rënien!
Ardi Stefa
28 Qershor, 16:44



Vila 4-katëshe në Tiranë sebep për nisjen e sherrit mes vëllezërve, arrestohet ish-drejtori i Policisë së Vlorës Sokol Mulosmani! Në pranga e 4 të tjerë
Sokol Dema
28 Qershor, 15:27



Balla inspekton punimet e rrugës dytësore në Kavajë: Zgjidhim problemin shumëvjeçar të banorëve dhe bizneseve
28 Qershor, 13:22



'Jam polic', 22-vjeçari kapet në Tiranë me dokumenta të rreme, në banesë i gjenden fishekë, para dhe medalione të Policisë
28 Qershor, 11:46



Shkoi të kthente frigoriferin që s'punonte, klientja mbahet 2 orë me forcë në dyqan, në pranga dy pronarët e ‘Zanusit’ në Tiranë
28 Qershor, 11:23



‘La Repubblica’ udhëton nga Tirana në Berat: Shqipëria përtej Adriatikut e Jonit, midis bunkerëve, vreshtave dhe sekteve të lashta
28 Qershor, 10:51



Protesta, theksohen kërkesat për Ramën! Dorëheqjen ia kërkuan përmes ministres me inteligjencë artificiale Diella (VIDEO+FOTO)
27 Qershor, 19:30



Testi i gjinisë për Nayara Ferreira-n, akt diskriminues nga federata e volejbollit! Komisioneri: Pezullimi i sportistes në bazë të steriotipeve
27 Qershor, 18:16



Eurodeputetja Salis në Tiranë për t’iu bashkuar protestës, ish-sekretarja e PD: Ndihem keq që paska mbetur Shqipëria ta shpëtojë kjo komunistja e Italisë
27 Qershor, 14:25

Lajmi i fundit



**Vrau me thikë vëllain pas sherrit për një copë rrugë, gjykata në Durrës lë në burg 76 vjeçarin Muhamet Rreshka**
29 Qershor, 12:02



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

× Lajmi i fundit



**Vrau me thikë vëllain pas sherrit për një copë rrugë, gjykata në Durrës lë në burg 76 vjeçarin Muhamet Rreshka**

29 Qershor, 12:02

GetButton